



**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"RES-ARBENI" SH.P.K**

Sot, më datë 22.02.2020, para meje Noter OLTIANA SHABANAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën DURRES, LAGJA 11, RR. ALEKSANDER GOGA, u paraqit personalisht:

THEMELUES/IT:

Vath Alla, atësia Haxhi, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Bizë, Durrës dhe banues në DURRES, me adresë 2016 Bizë Bize 019 00 000, lindur më 14/01/1976, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 026368995 dhe nr. personal H60111170L , .

THEMELUES/IT:

Astrit Alla, atësia Haxhi, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Drraç, Durres dhe banues në DURRES, me adresë Bizë Bize 000 0 0, lindur më 16/06/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 031239716 dhe nr. personal I40616015T , .

THEMELUES/IT:

Selim Alla, atësia Haxhi, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Bize, Durres dhe banues në DURRES, me adresë 2016 Bizë Bize 019 0 0, lindur më 21/03/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 031954341 dhe nr. personal H80321008J , .

THEMELUES/IT:

Xhaferr Alla, atësia Haxhi, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Drraç, Durres dhe banues në DURRES, me adresë 2016 Bizë Bize 019 0 0, lindur më 11/02/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 029709690 dhe nr. personal I20211008U , .

Duke u bazuar në:

- *Vullnetin tonë të lirë, të plotë dhe të singertë, dhe iniciativën e lirë private.
- * Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi.
- * Në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"
- * Në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Bizneseve"
- * Ne Ligjin Nr. 7667 datë 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar", atë Doganor, Fiskal e Tatimor në normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare dhe ato të Komunitetit European, me anën e këtij AKTI, krijojmë Shoqërinë Tregtare me Ortakëri të përbashkët dhe vendase "RES-ARBENI" Shpk, Durres, Shqipëri.

NENI I

SHOQËRIA Tregtare, formohet nga ne Ortakët e saj më emër subjekti "RES-ARBENI" shpk, emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

(Four handwritten signatures in blue ink)



NENI 2

SELIA Qëndrore e Shoqërisë "RES-ARBENI" Shpk është në Adresën: Ishëm, fshati Shetaj, Kepi i Rodonit, Parcela 45 Durrës, Z.K. 3365.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjenci dhe Përfaqësi, si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Njësitë e tjera Strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së Drejtës Ndërkombëtare Private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

KAPITALI Themeltar i Shoqërisë është **100.000,00** (njëqind mijë) **Lek** i formuar dhe nënshkruar nga Ortakët Themelues **Z. Vath ALLA, Astrit ALLA, Selim ALLA dhe Z. Xhaferr ALLA**, zotërues sejcili me 25,00 % të Kuotave të Kapitalit Themeltar me vlerë **25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek sejcili në para (Vath Alla 25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek, Astrit Alla 25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek, Selim Alla 25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek dhe Xhaferr Alla 25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek.**

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj Kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.

Shoqëria përgjigjet vetëm me Kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i-përfaqësuar me Letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, bëhet para kërkesës për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person Juridik, pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve (QKB-së), në Regjistrin Tregtar të saj.

NENI 6

KOHËZGJATJA e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është për **30 vjet**, duke filluar ky afat nga data e Regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person JURIDIK.

Me **VENDIM** të Asamblesë së Ortakëve **KOHËZGJATJA** e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky **VENDIM** i dërgohet menjëherë për depozitim QKB-së (Qendrës Kombëtare të Bizneseve), për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.



NENI 7

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti THEMELIMI dhe STATUTIT të saj.

NENI 8

Shoqëria çel Llogari BANKARE në lek vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

ORTAKËT dhe Administratori i Përgjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në BANKAT ku është çelur llogaria, dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur ÇEKU bankar është firmosur nga njëri Ortak që është caktuar dhe Administratori i Shoqërisë, dhe në rastin kur Ortakët kanë caktuar më shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakërisë, çeku bankar dhe çdo likujdim apo pagesë nënshkruhet nga Ortaku që është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe nga Administratori jashtë saj.

NENI 9

PJESËT e Kapitalit THEMELTAR, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht KONTRIBUTET e saj, përfshirë dhe FONDET e Kontributet në NATYRË.

TRANSFERIMET e pjesëve të Kapitalit Themelor, duhet të jenë të vërtetuara me **AKT Noterial** dhe për një gjë të tillë ORTAKËT duhet të marrin paraprakisht **VENDIM me shkrim**, i cili ushtron efektet juridike vepruese të tij, vetëm në rast se është legalizuar nga një NOTER.

SHOQËRIA dhe të tretët, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 10

SHOQËRIA krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këto DREJTIME:

Restorant, Bar-Kafe. Mbarështimi i florës së egër dhe ushtrimin e veprimtarive pushimi rekreative për turizëm. Shtëpi pushimi dhe kamping.

NENI 11

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër Tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

NENI 12

Asambleja e Ortakëve, është **Organi me i lartë Drejtues** dhe **VENDIMOR** i Shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që Ligji "Për Shoqëritë Tregtare" i njeh ASAMBLESEË së Ortakëve që janë krijuar me Ortakëri.

Ortakët në mirëkuptim dhe duke vënë paraprakisht në dijeni njëri-tjetrin, mund t'ja delegojnë KOMPETENCAT një ose më shumë Administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një Personi Fizik apo Juridik, vendas ose të huaj jashtë ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazën e PROKURËS të bërë me Akt Noterial.

NENI 13



Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet një person dhe konkretisht:

Z. Xhaferr ALLA, atësia Haxhi, i datëlindjes 18.03.1973, shtetas shqiptar, lindur në Drraç Durrës dhe banues në Bizë Durrës, identitet verifikuar me Letërnjoftimin ID Nr. 029709690 dhe Nr. Personal Nr. I20211008U, i cili zgjidhet me afat pesë vjeçar.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES/IT

Vath Alla

Vath Alla

THEMELUES/IT

Astrit Alla

Astrit Alla

THEMELUES/IT

Selim Alla

Selim Alla

THEMELUES/IT

Xhaferr Alla

Xhaferr Alla

NOTER
OLTIANA SHABANAJ

[Signature of Noter]





A2020014360002673744



STATUT

KREU I

EMËRTIMI – OBJEKTI – SELIA – KOHËZGJATJA

NENI 1

Është krijuar, sot më datë 22.02.2020 (dy mijë e njëzet), në qytetin e Durrësit, nga ne Ortakët Themelues shtetasit shqiptar:
Shoqëria Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “RES-ARBENI” Shpk Durrës – Shqipëri.

NENI 2

Shoqëria Tregtare është vendase dhe quhet me emrin “RES-ARBENI” Shpk Durrës, Shqipëri, emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 3

SELIA Qëndrore e Shoqërisë “RES-ARBENI” Shpk, është në **Adresën: Ishëm, fshati Shetaj, Kepi i Rodonit, Parcela 45 Durrës, Z.K. 3365.**

NENI 4

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, mund të krijohen ose anulohen (në rast se janë çelur) Seli, Filiale, Agjenci dhe Përfaqësi, si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Njësitë e tjera Strukturore të Shoqërisë, si Degë apo Përfaqësi jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë e parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së Drejtës Ndërkombëtare Private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 5

KAPITALI Themeltar i Shoqërisë është **100.000** (njëqind mijë) **Lek** i formuar dhe nënshkruar nga Ortakët Themelues Z. Vath Alla, Z. Astrit Alla, Z. Selim Alla dhe Z. Xhaferr Alla, zotërues sejcili me 25% të Kuotave dhe Kapitalit Themeltar me vlerë **25.000,00** (njëzet e pesë mijë) **Lek sejcili.**

Ortakët kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj Kapitali, mjete



xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme.
Shoqëria përgjigjet vetëm me Kapitalin e saj.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jetë kurrë i përfaqësuar me Letra me vlerë dhe derdhja e Kapitalit themeltar të Shoqërisë, bëhet para kërkesës për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person Juridik, pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve (QKB-së), në Regjistrin Tregtar të saj.

NENI 7

KOHËZGJATJA e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është për 30 vjet, duke filluar ky afat nga data e Regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person JURIDIK.

Me VENDIM të Asamblesë së Ortakëve, KOHËZGJATJA e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshojë dhe ky VENDIM i dërgohet menjëherë për depozitim QKB-së (Qendrës Kombëtare të Bizneseve), për të bërë shënimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

NENI 8

OBJEKTI

SHOQËRIA krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj tregtar në këtë DREJTIM:

Restorant, Bar-Kafe. Mbarështimi i florës së egër dhe ushtrimin e veprimtarive pushimi rekreative për turizëm. Shtëpi pushimi dhe kamping.

NENI 9

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik që nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve (QKB-së), si dhe pasi të jetë regjistruar dhe pajisur me ÇERTIFIKATAT përkatëse në Organin e Degës së Tatim Taksave Durrës.

NENI 10

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi, si atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimtarisë, si dhe mbi bazën e AKT THEMELIMIT dhe STATUTIT të saj.

KREU I

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria çel Llogari BANKARE në lek vendi dhe çdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.

ORTAKËT dhe Administratori i Përgjithshëm i caktuar prej tyre, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në BANKAT ku është çelur llogaria dhe tërheqja e pjesëve të saj bëhet kur ÇEKU bankar është firmosur nga njëri Ortak që është caktuar dhe Administratori i Shoqërisë, dhe në rastin kur Ortakët kanë caktuar më shumë se një Administrator, i cili është jashtë ortakërisë, çeku bankar dhe çdo likuidim apo pagesë nënshkruhet nga Ortaku që është Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe nga Administratori jashtë saj.

NENI 12

(Handwritten signatures in blue ink)



PJESËT e Kapitalit THEMELTAR, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë Territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht KONTRIBUTET e saj, përfshirë dhe FONDET e Kontributet në NATYRË.

TRANSFERIMET e pjesëve të Kapitalit Themelor, duhet të jenë të vërtetuara me **AKT Noterial** dhe për një gjë të tillë **ORTAKËT** duhet të marrin paraprakisht **VENDIM me shkrim**, i cili ushtron efektet juridike vepruese të tij, vetëm në rast se është legalizuar nga një **NOTER**.

SHOQËRIA dhe të tretët, duhet të respektojnë këto Transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 13

KAPITALI Themeltar i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet, mbi bazën e Vendimit me shkrim që merr **ASAMBLEJA E ORTAKËVE**, i cili nënshkruhet prej tyre dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet në Regjistrin përkatës të QKB-së.

Çdo **VENDIM** i Asamblesë së Ortakëve, për ndryshimin e Kapitalit Themeltar i dërgohet menjëherë Qendrës Kombëtare të Bizneseve për të pasqyruar ndryshimet përkatëse.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË TË DREJTAT DHE DETYRAT

NENI 14

Asambleja e Ortakëve, është **Organi me i lartë Drejtues** dhe **VENDIMOR** i Shoqërisë dhe ajo ushtron të gjitha kompetencat që Ligji "Për Shoqëritë Tregtare" i njeh **ASAMBLESE** së Ortakëve që janë krijuar me Ortakëri.

Ortakët në mirëkuptim dhe duke vënë paraprakisht në dijeni njëri-tjetrin, mund t'ja delegojnë **KOMPETENCAT** një ose më shumë Administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një Personi Fizik apo Juridik, vendas ose të huaj jashtë ortakërisë së Shoqërisë, mbi bazën e **PROKURËS** të bërë me Akt Noterial.

ADMINISTRATORI ose **PËRFAQËSUESI** me Prokurë, janë individualisht përgjegjës ndaj **SHOQËRISË** apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë **STATUT** dhe për dëmin e shkaktuar me **FAJ**, sipas rastit, çdo Ortak mund të ngrejë **PADI Civile** dhe të kërkojë ndaj tyre shlyerjen e plotë të dëmit të shkaktuar, përfshirë dhe fitimin e munguar, duke patur njëkohësisht dhe të drejtën për të bërë kallxim për ndjekje penale në **PROKURORINË** e juridiksionit tokësor përkatës.

NENI 15

Me Vendim të asamblesë së Ortakëve, Shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptar apo të huaj, ose të bashkohet me një Shoqëri tjetër Tregtare si brenda vendit dhe jashtë tij.

NENI 16

ORTAKËT e Shoqërisë kanë dhe këto të **drejta dhe detyra kryesore**:

* Të marrin pjesë ne Drejtimin dhe Administrimin e gjithanshëm të veprimtarisë Ekonomiko Tregtare të Shoqërisë dhe të çdo veprimtarie tjetër të saj, kur ajo ushtrohet në përputhje me Ligjet, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj.

* Të kërkojnë dhe ti jepen të gjitha **INFORMATAT** që kanë të bëjnë me gjendjen Tregtare dhe Financiare të veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentacionin e përpunuar nga Shoqëria, ato që kanë të bëjnë me nxjerrjen e rezultatit Ekonomik të **BILANCIT** Kontabël, apo për çdo llogari të çelur, si të

asaj Likuiduese dhe asaj Rrjedhëse.

* Të marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në çfarëdo forme apo sasi, sipas kontributit të dhënë prej tyre.

* Të kryejnë shërbime për realizimin e objektivave dhe qëllimeve të veprimtarisë së rregullt ligjore të Shoqërisë.

* Me Vendim të Asamblesë, Ortakët EMËROJNË dhe SHKARKOJNË në çdo kohë **Administratorin e Shoqërisë, si dhe Ekspertin KONTABËL** të autorizuar.

- Sejcili ORTAK si kryesisht dhe me anë të Administratorit brenda Ortakërisë ose të tij të emëruar jashtë ortakërisë dhe kur ky i fundit është i pajisur me PROKURË, ushtrojnë dhe këto **TAGRA (të Drejta):**

Kryerjen e të gjitha veprimeve juridike dhe hartimin e akteve që konsiderohen se janë të domosdoshme për ushtrimin e gjithanshëm dhe fitimprurës të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë sipas qëllimeve dhe objektivave të saj siç mund të jenë:

1. Të lidhin Kontrata të ndryshme që kanë për objekt Blerjen, Shitjen, Këmbimin dhe Marrjen me Qira të PASURIVE të ndryshme (të luajtshme dhe të paluajtshme), si me persona fizikë dhe me Persona juridikë vendas apo të Huaj si dhe me SHTETIN. Në rastin e blerjes së Pasurive të Paluajtshme apo marrjen e tyre me QIRA për një periudhë kohore mbi 9 VJET (si dhe të kontratave të Servitutit, Uzufruktit dhe Enfiteozës) duhet të bëjnë regjistrimin në ASHK-në (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) të Rrethit të Juridiksionit përkatës, si për transkriptimin e Pronësisë në favor të Shoqërisë apo kalimin e kësaj pasurie në posedim ligjor.

Çdo blerje e pasurive të mësipërme, konsiderohet dhe si shtesë e Kapitalit në Natyrë.

2. Të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha Zyrave shtetërore dhe Private, BANKAVE të çdo niveli etj, që kanë të bëjnë me GARANCITË, Sipërmarrjet, Marrjen e Kredive, të Siguracioneve dhe Risiguracioneve për jetën dhe Dëmet, Transportit (brenda dhe jashtë vendit) kryerjen e veprimeve doganore për zhdoganimin e mallrave të importuara, deklarimin e tyre të eksportuar, plotësimin në kohë dhe me rregullsi të dokumentacionit Fiskal, Tatimor, Bankar etj...

Në rastet kur Veprimet juridike kryhen nga **ADMINISTRATORI i emëruar nga Ortakët** ose personi që Përfaqëson njërin nga Ortakët mbi bazën e PROKURËS, këta janë të detyruar që në përfundim të realizimit të veprimit përkatës të njoftojnë menjëherë dhe ti japin llogari Asamblesë së Ortakëve.

3. ADMINISTRATORI ose PËRFAQËSUESI me Prokurë, janë individualisht përgjegjës ndaj SHOQËRISË apo të tretëve, për veprime të kryera në shkelje të ligjeve dhe që bien në kundërshtim me këtë **STATUT.**

Për dëmin e shkaktuar **me FAJ** sipas rastit, çdo Ortak mund të ngrëjë PADI Civile dhe të kërkojë ndaj tyre shlyerjen e plotë të dëmit të shkaktuar, përfshirë dhe fitimin e munguar, duke patur njëkohësisht dhe të drejtën për të bërë kallëzim penal në **PROKURORINË** e juridiksionit tokësor përkatës.

NENI 17

PËRFAQËSIMI i Shoqërisë, në marrëdhëniet me të tretët si brenda dhe jashtë vendit si rregull dhe përgjithësisht i përket Administratorit të Shoqërisë.

NENI 18

Çdo Ortak dhe ADMINISTRATORI i Shoqërisë i emëruar prej Ortakëve, kanë të drejtë që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të Shoqërisë, të punësojnë specialistë të ndryshëm, madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar, duke lidhur KONTRATËN E PUNËS sipas kriterëve që parashikohen në Kodin e Punës në fuqi, në Ligjin "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, dhe rregullat teknike e të disiplinës profesionale të caktuara nga ana e Punëdhënësit.



Administrator i Përgjithshëm i Shoqërisë, caktohet një person dhe konkretisht:

Z. Xhaferr Alla, atësia Haxhi, i datëlindjes 11.02.1982, shtetas shqiptar, lindur në Draç Durrës dhe banues në Bizë Durrës, identitet verifikuar me Letërnjoftimin ID Nr. 029709690 dhe Nr. Personal Nr. I20211008U, i cili zgjidhet me afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar ky afat nga data e Regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, për njohjen dhe regjistrimin e Shoqërisë si Person JURIDIK.

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

NENI 19

Veprimet ekonomiko-financiare të Shoqërisë, mbyllen më datën **31 Dhjetor të çdo viti**.

Nxjerrja e Bilancit financiar vjetor, bëhet duke respektuar rregullat mbi Kontabilitetin dhe brenda 6 Muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

Për nxjerrjen e rezultatit KONTABËL të Shoqërisë, mbi bazën e Aktivit dhe Pasivit nga ana e Ortakëve, caktohet një EKSPERT Kontabël i AUTORIZUAR.

EKSPERTI ka për detyrë që të kontrollojë dhe verifikojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë Ekonomiko-Tregtare të Shoqërisë, si atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë mbi bazën e **Vendimit** të marrë nga Ortakët e Shoqërisë.

Në përfundim të Kontrollit, Eksperti kontabël i autorizuar përgatit RAPORTIN me shkrim për nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të BILANCIT financiar vjetor si dhe Raportin për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, i cili është Organi i vetëm për ti shqyrtuar dhe miratuar ato, mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

NENI 20

Nxjerrja e rezultateve të BILANCIT vjetor, duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të sistemit të Tatim Taksave, që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari Tregtare.

EKSPERTI Kontabël i autorizuar përveç të drejtave, ka dhe këto **detyrime**:

1. Garantoni Asamblesë e Ortakëve se llogaritë vjetore janë të rregullta dhe Bilanci është nxjerrë me saktësi dhe konform rregullave të Ligjit "Mbi Kontabilitetin".

2. Të pasqyrojë me vërtetësi rezultatet e operacioneve të vitit të kaluar financiar dhe gjendjen reale financiare të Shoqërisë në mbylljen e vitit financiar të aktivitetit tregtar të saj.

3. Të verifikojë përputhjet me llogaritë vjetore të Informacioneve të dhëna nga Administratorët e Shoqërisë në Mbledhjet e Asamblesë së Ortakëve, duke përfshirë dhe dokumentat për gjendjen financiare që ai (Administratori) i ka paraqitur Asamblesë së Ortakëve.

4. T'i bëjë të njohur Ortakëve dhe Administratorit të Shoqërisë: Kontrollet dhe verifikimet që janë bërë prej tij për kontrolle periodike ose vjetore, duke vënë në dukje parregullsitë apo pasaktësitë e konstatuara, masat ligjore për rregullimin e tyre etj...

5. EKSPERTI Kontabël i autorizuar është përgjegjës ndaj Shoqërisë dhe ndaj të tretëve për pasojat e dëmshme të shkaktuara me fajin e tij (Dashje ose pakujdesi) aktivitetit tregtar të Shoqërisë, por nuk është përgjegjës kur këto DËME shkaktohen pa dijeninë e tij dhe nga veprimet me faj të Administratorit të Shoqërisë.

NENI 21

BILANCI Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e VENDIMIT me shkrim të marrë nga Ortakët në Mbledhjen e Asamblesë së ortakëve, në të cilin ai jo vetëm që dokumenton aprovimin e tij por dhe që përcakton dhe në lidhje me disponibilitetin e FONDEVE ligjore, sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm



të aktivitetit të Shoqërisë, por dhe për GARANTIMIN e veprimtarisë së rregullt të saj, duke patur parasysh Fondin e Akumulimit, krijimin e fondit të veçantë etj.

Për Formimin e fondit rezervë, që emërtohet "**Rezervë e domosdoshme**", Ortakët vendosin që nga fitimi i akumuluar gjatë vitit financiar, pasi të zbriten humbjet e vitit të mëparshëm, të lërë të paktën **1/20 e vlerës** së FITIMIT të realizuar.

NENI 22

Të ARDHURAT neto (DIVIDENTI) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi tatimor e fiskal apo likuidimin e pagesave, ose ekzekutimin e detyrimeve (debive) ndaj të tremeve, i kalojnë në PRONËSI, Ortakëve në raport me përqindjen e Kontributit financiar që ata kanë dhënë në krijimin e Kapitalit Themeltar.

NENI 23

SHPËRNDARJA ose Prishja e SHOQËRISË, mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të AFATIT për të cilin është krijuar Shoqëria siç mund të jenë:

- a. Humbja e Kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b. Në një nga mënyrat e parashikuara nga Ligji "Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare".
- c. Me kërkesën e njërit Ortak dhe kur kjo pranohet nga Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve.

Në këtë rast se Ortakët, marrin VENDIM me shkrim në të cilin parashikon dhe mënyrën e LIKUJDIMIT të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likujdatorë dhe duke lëshuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e Likujduesit dhe emërtesën SHITESË, "**Shoqëri në likuidim e sipër**".

NENI 24

Akti i EMËRIMIT të Likujdatorit, PUBLIKOHET sipas kushteve që parashikon Ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në ANEKSIN e regjistrimit Tregtar.

NENI 25

LIKUIDUESI është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve Shoqëria është Kreditorë dhe për ekzekutimin e plotë të detyrimeve (debive) që Shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçantë apo personave fizik ose juridik vendas apo të huaj.

NENI 26

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht Ortakët duhet ta zgjidhin në mirëkuptim, në të kundërt çështjen mund ta bëjnë objekt Konflikti gjyqësor.

Të drejtën e ngritjes së Padisë gjyqësore, në rast konflikti civil, çdo Ortak e disponon në mënyrë të pavarur, duke e ngritur atë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

NENI 27

Përsa nuk është shprehur në këtë STATUT i referohet udhëzimeve plotësuese e konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të dhëna nga ana e Ortakëve të Shoqërisë, si dhe hapësirave juridike lejuese të Legjislacionit në fuqi.

NENI 28

**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Unë Noteri verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES/IT

Vath Alla

*Vath Alla***THEMELUES/IT**

Astrit Alla

*Astrit Alla***THEMELUES/IT**


Selim Alla

*Selim Alla***THEMELUES/IT**

Xhaferr Alla

Xhaferr Alla

NOTER
OLTIANA SHABANAJ

*[Large handwritten signature]*